

MARSELA HARIZAJ

**AFTËSIMI I MENDIMIT KRITIK DHE KRIJUES TË NXËNËSVE TË
GJUHËS SË HUAJ NËPËRMJET MËSIMDHËNIES ME NË QENDËR
NXËNËSIN**

Abstrakt

Zhvillimet e fundit në epokën e re të globalizimit pasqyrojnë ndryshimet dhe nevojën e shoqërisë shqiptare për të përparuar. Një rëndësi të veçantë sot në vendin tonë merr koncepti i arsimimit i cili pasqyron vlerat e shoqërisë. Theksi vendoset tek të mësuarit e gjuhës së huaj veçanërisht asaj angleze si një domosdoshmëri për t'u integruar, punësuar dhe edukuar. Modelet e mësimdhënies tradicionale tashmë ja kanë lenë vendin metodave ndërvepruese ku mësimdhënia ka në qendër nxënësin dhe jo më mësuesin. Kërkimet studimore kanë treguar se koncepti i mësimdhënies së gjuhës së huaj fokusohet tek nxënësi sepse i siguron atij të mësojë gjuhën në ndërveprim, për një përdorim real jashtë mureve të klasës. Kjo metodë i jep mundësi ta vlerësojë dhe ta përdori gjuhën dhe format e saj për funksione të ndryshme gjuhësore, si dhe nxit të menduarit kritik dhe krijues të nxënësit.

Mësimdhënia me në qendër nxënësin jep efikasitet në mësimnxënie duke e ekspozuar nxënësin në veprimtari komunikative duke kombinuar strategjitë, teknikat efikase të cilat e motivojnë nxënësin dhe i mundësojnë të shprehurin lirshëm të mendimeve dhe perceptimeve. Përdorimi i materialeve autentike, vlerësimi ndërkulturor nxit efikasitetin dhe pritshmërinë e nxënësve dhe mësuesve. Nëpërmjet nxitjes së mendimit kritik, nxënësit zgjerojnë korpusin gjuhësor, rrisin aftësinë njohëse të tyre.

Fjalë kyçe: Nxitja e mendimit kritik, efikasiteti i mësimdhënies, veprimtaritë komunikative.

1. Mësimdhënia efikase në orët e gjuhës së huaj

Të mësuarit e një gjuhe të huaj sot është bërë një domosdoshmëri jetike përse i përket përdorimit të saj në fusha të ndryshme të jetës. Për këtë arsye me rëndësi është cilat metoda zbatohen në mësimdhënie, sa bashkëkohore janë ato dhe a realizohet botëkuptimi i të mësuarit. Për nxënësin nuk është thjesht e rëndësishme të mësojë gramatikën, por të mësojë gjuhën në mënyrë që ta përdori atë për të shprehur lirshëm mendimet e veta. Një mësimdhënie efikase çon në një mësimnxënie efikase. Për këtë arsye duhet analizuar çdo komponent i procesit mësimor. Nga eksperiencia e mësuesve dhe studimet e bëra, sot theksi vendoset tek mësimdhënia me në qendër nxënësin. Në këtë mënyrë

nxënësit i lihet hapësira e nevojshme për të bashkëvepruar, studiuar dhe lirshmëria në të folur në gjuhën e huaj.

Mësimdhënia efikase ka tiparet dhe parimet e veta. Përveç mënyrës të zbatimit sa më të mirë nëpërmjet veprimtarive dhe detyrave komunikuese, rol kryesor luajnë edhe mënyra se si tre komponentët bazë të mësimdhënies efikase zbatohen. Këto komponentë të procesit mësimor janë: shpjegimi, të pyeturit dhe dhënia e fidbekut. *Cili është roli që luan mësuesi dhe cilat janë mënyrat sesi ai/ajo ndërthur procesin mësimor?* Në përdorimin e strategjive të ndryshme të mësimdhënies, fokusi është tek mënyra e të nxënësve nga ana e nxënësit të cilat sigurojnë një pjesëmarrje aktive. Veprimtaritë që kanë në bazën e tyre komunikimin dhe informacionin e plotë janë përdorur për të arritur këto strategji. Mësimi i drejtpërdrejtë, puna në grup dhe zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik zhvillojnë aftësitë e nxënësve në procesin e të nxënësve.

Kur shpjegohet diçka e re duhet bërë interesante për të tërhequr vëmendjen e nxënësve. Nuk duhet folur shumë shpejt që ata të kuptojnë atë që flitet. Gjithashtu është e rëndësishme të mos jepen shumë gjëra në të njëjtën kohë. Prandaj, në prezantimin e materialit të ri është mirë të përdoren hapa relativisht të vogla, të cilat ndjekin njëra-tjetrën, duke filluar nga praktika, përpunimi, detyrat dhe përmbledhja¹. Delia² dhe Tabaku theksojnë se mësimdhënia mund të bëhet më efikase nëse nxënësve u krijohen kushtet për rritjen e mësimnxënies së tyre. Çdo praktikë e mësimi që zhvillon aftësinë komunikuese në një kontekst autentik quhet formë e pranueshme dhe fitimprurëse për nxënësin. Mësimi i gjuhës së huaj për qëllime komunikimi merr në klasë formën e punës në çift apo në grup, kërkon negociim dhe ndërveprim midis nxënësve, veprimtari me bazë influencuese që i inkurajon nxënësit të zhvillojnë besimin e tyre, veprimtari me role në të cilat nxënësit praktikojnë dhe zhvillojnë funksionet e gjuhës, dhe gjithashtu veprimtari për shqiptimin dhe gramatikën.

Nëse duam të kemi komunikim dhe mësimnxënie, të gjithë pjesëmarrësit duhet të kenë njohuri, aftësi e mënyra të sjelluri. Mësuesi nuk duhet të merret me vënien e rregullit në klasë, por me nxitjen e nxënësve që të marrin pjesë në diskutime³. Një mësues i përgatitur mirë, do të sigurojë një mjedis për të zbatuar mësimdhënien me në qendër nxënësin, kështu që ndërveprimet e klasës duhet të jenë reale dhe të kuptimta, por gjithmonë mësuesi duhet të jetë pranë nxënësit, që gjuha të kuptohet dhe të flitet saktë.

¹ Leonard H. Clark & S. Starr. S. Irving, *Secondary and Middle School Teaching Methods*. Macmillan Publishing Company, New York, 1991, f. 211.

² Shpresa Delija & Elida Th. Tabaku, *Language Teaching Methodology*, Geer, Tiranë, 2009, f.83.

³ Bardhyl Musai, Kualida, *Program për kualifikimin në distancë të arsimtarëve (Anglisht)*, Aspekte të mësimdhënies, Tiranë, Pegi, 1997, f.18.

2. Roli i mësuesit për nxitjen e mendimit kritik dhe krijues të nxënësve

Në mësimdhënien me në qendër nxënësin, roli i mësuesit nuk zbehet, por është shumë i rëndësishëm. Ka shumë studime mbi rolin dhe detyrat që një mësues duhet të ketë në orët e gjuhës së huaj, në mënyrë që të ndihmohet nxënësi për të arritur objektivat e caktuara. Këto studime janë nxjerrë nga kërkimet dhe vëzhgimet që vetë mësuesit e gjuhëve të huaja kanë nxjerrë nga eksperiencat e tyre. Studime të ndryshme mbi rolin e mësuesit në klasë lidhen me mësimdhënien efikase. Ka mendime të njëjta përsa i përket rolit dhe detyrat e çdo mësuesi për një mësimdhënie efikase.

Sipas Musait njohja e këtij roli është e rëndësishme dhe e nevojshme, sepse shërben si një instrument vlerësimi për punën e çdo mësuesi e nga ana tjetër tregon sa i gjatë, lodhës, delikat dhe serioz është ky proces. Sipas tij rolet më kryesore në klasat me në qendër nxënësin janë: roli i organizuesit, vlerësuesit, motivuesit, udhëheqësit të procesit mësimor dhe partnerit të ndërveprimit në klasë. Një nga vetitë më me rëndësi për një mësimdhënie të mirë është vetëdërgjegjësimi, i cili përfshin aftësinë që duhet të ketë mësuesi për të reflektuar në mësimdhënien e tij.

Richards thekson se mbarëvajtja dhe notat e nxënësve pasqyrojnë efikasitetin në mësimdhënien e gjuhës angleze në klasat ku gjen zbatim metoda e të mësuarit të gjuhës për qëllime komunikative, por një informacion më i saktë për mbarëvajtjen e mësimin merret nga vetë mësuesit, duke monitoruar veten e tyre. Kërkimet kanë treguar se mësuesit e suksesshëm në mësimdhënien e gjuhës së huaj, janë të hapur dhe fleksibël në marrëdhënien me nxënësit. Kjo cilësi pasqyrohet edhe nga vetë nxënësit. Prezantimi i mësimin tek fëmijët, shpjegimi, të përgjigjurit ndaj pyetjeve të nxënësve, janë tre nga veprimtaritë në të cilat mësuesit përfshihen.

Westood ka zhvilluar një koncept tjetër, sipas të cilit një mësimdhënie efikase varet nga një mësues efikas, i cili duhet t'i ketë role të qarta. Rolet kanë të bëjnë me të qenit aktiv, i duruar, entuziast, punëtor, i paanshëm, ndihmës etj. Ndërsa detyrat e mësuesit kanë të bëjnë me organizimin sa më të mirë të orës së mësimin me ndryshimin e metodologjisë, me përdorimin e një shumëllojshmërie materialesh autentike, me adoptimin e mësimdhënies sipas nevojave gjuhësore të nxënësve. Gjithashtu mësuesi duhet të jetë monitorues i veprimtarive dhe detyrave të dhëna si dhe manazhues i mirë i kohës.

Në një klasë komunikative, fokusi nuk është tek gramatika, prandaj mësuesi vepron si ndihmës dhe lehtësues duke i ndihmuar nxënësit të bëjnë lidhje të përdorimit të gjuhës me detyrat e caktuara. Për këtë arsye leximi, shpjegimi, dhe pritshmëria nga ana e nxënësit rregullohet në bazë të nivelit gjuhësor. Në rast se diskutimi, apo pjesa që do lexohet përmban fjalë të vështira mësuesi ndihmon dhe lehtëson me anë të shpjegimit dhe qartësimin me fjalë që nxënësit i kuptojnë. Delija dhe Tabaku theksojnë se rolet e

mësuesit ndryshojnë vazhdimisht, e rëndësishme është që ato të zgjidhen sipas qëllimit të mësimnxënies dhe veprimtarive udhëzuese në klasa.

Sipas Krashenit, sukcesi i nxënies varet nga informacioni hyrës i kuptueshëm për nxënësin, kështu që mësuesi bëhet koshient për aftësinë e nxënësit për të mësuar diçka të re dhe për të kuptuar edhe pjesë nga gjuha që i dëgjon për herë të parë (p.sh. fjalë të reja). Në këtë rast detyrat dhe roli i mësuesit janë:

- *Shpjegimi i fjalëve dhe terminologjisë së re me kujdes*
- *Përdorimi i diagramave dhe mjeteve vizuale*
- *Shpjegimi në mënyrë të strukturuar*
- *Dhënia e detyrave sipas aftësisë dhe vështirësisë*

3. Rëndësia e përdorimit të veprimtarive dhe detyrave komunikative

Ekzistojnë përkufizime të ndryshme për fjalën detyrë, megjithatë, duke pasur parasysh fokusin e këtij punimi është e mjaftueshme të thuhet se detyrë është çdo veprimtari që gjeneron një nevojë të vërtetë për të përdorur gjuhën. Ndryshe nga ushtrimet gramatikore, detyrat në mësimdhënien e gjuhës së huaj sot përqëndrohen tek rrjedhshmëria dhe jo saktësia. Përsa i përket përdorimit të detyrave marrëse, veprimtaritë në leximin intensiv dhe ekstensiv si dhe veprimtaritë dëgjimore rrisin komunikimin nga ana e nxënësit. *Parimi bazë i mësimdhënies është zhvillimi i komunikimit me anë të veprimtarive komunikative, duke pasur gjithashtu edhe orë të gjuhës angleze ku praktikohen aftësitë gjuhësore marrëse siç është dëgjimi, p.sh. dëgjimi i një kënge, anekdote, leximi i një artikull gazete, duke e vendosur theksin tek kuptimi i përgjithshëm, i cili ka për qëllim të zhvillojë arritjen nga lart- poshtë të të kuptuarit të gjuhës së folur dhe të shkruar.*

Për këtë qëllim, nxënësit e gjuhës së dytë apo të huaj pritët të praktikojnë aftësitë e tyre produktive mjaft shpesh në një klasë ku bazohemi tek detyrat për arritjen e komunikimit. Për t'i bërë nxënësit të thonë që të shkruajnë diçka në gjuhën e caktuar, mësuesi përdor detyra të ndryshme spontane, të ngjajshme me jetën reale, ligjërimore të tilla si *anketa, role, debate, zgjidhja e problemeve, kuice, lojëra*, etj., në të cilat nxënësit ndjehen më të lirshëm për të folur. Duke marrë pjesë në veprimtaritë e ndryshme nxënësit inkurajohen për të zhvilluar krijimin e një sistemi kuptimor, të rrisin aftësinë e tyre për të kuptuar në mënyrë kritike; të thellojnë dhe përdorin njohuritë e tyre gjuhësore. Forma gjuhësore që ata do të përdorin për të përcjellë mesazhin nuk është thelbësore. Po kështu, udhëzimet gramatikore dhe korrigjimi i gabimeve nuk përbëjnë përparësi. Schmitt përsa i përket mësimdhënies, studimit të fjalorit, argumenton se detyrat që kanë për bazë rritjen e komunikimit japin pak udhëzime se si të merren për fjalorin, ato më tepër orientojnë si ta përdorim atë në funksion të gjuhës. Pra, mënyra më praktike nënkupton që fjala duhet të mësohet në kontekst. Dhe sigurisht nga ana e mësuesit mund të përdoren

lojëra të ndryshme, gjëgjëza, fjalëkryqe. Forma të tjera efikase janë puna individuale si eseja, puna në grup duke marrë pjesë në diskutime të ndryshme për çështje interesante për nxënësit, si dhe projekte të ndryshme. Këtu mund të përfshijmë diskutimin mbi një libër jashtëshkollor në gjuhën angleze, ku nxënësit zhvillojnë mendimet e tyre duke analizuar si veprën ashtu edhe autorin. Duhet të kemi gjithmonë parasysh moshën dhe nivelin gjuhësor të nxënësve.

Nxënësit janë më të prirur të bashkëpunojnë me mësues që janë më të dashur me ta. Në mësimdhënien me në qendër nxënësin, roli i mësuesit si partner i ndërveprimit në klasë është që të ulë barrierat e stresit për të rritur kohën e të nxënësit dhe t'i mësojë nxënësit të ndihmojnë njëri-tjetrin në detyrat e të nxënësit dhe të organizimit të punës. Edhe nxënësit që janë të ndrojtur, duke punuar me shokët në grup, dalëngadalë do të futen në rrjedhën mësimore. Nxënësit do të jenë më të motivuar të studiojnë një gjuhë të huaj sepse ndiejnë se po mësojnë diçka të dobishme me gjuhën.

Gjithashtu mësuesit u japin mundësi nxënësve të shprehin individualitetin e tyre duke ndarë idetë dhe opinionet me njëri - tjetrin. Në këtë mënyrë rritet besimi në vetëvete me anë të ndërveprimit, që kryejnë me mësuesin dhe shokët e tyre. Është më e lehtë të mësosh në një klasë të këndshme, kur mësuesi është i qeshur, se sa në një klasë ku mbizotëron zymtësia, prandaj atmosfera në klasë është tepër e rëndësishme. Detyra e mësuesit nuk është të vendosë rregulla, por të shtrijë procesin mësimor. Krijimi i një atmosfere të këndshme është tepër e rëndësishme për vetë faktin se një klasë e menaxhuar mirë është një vend miqësor. Duhet të merret parasysh se mësuesi është burimi i forcimit si për sjellje pozitive, ashtu edhe për sjellje negative. Nëse sjellja e mësuesit tregon besim, durim, atëherë nxënësit do të jenë gati t'i përgjigjen mësimdhënies. Burimi i një mbarëvajtjeje të mirë mësimore është trajtimi i nxënësve në mënyrë të njëjtë. Për të zhvilluar tek nxënësit zakone, vlerësime apo ideale duhet t'u sigurohet përvoja që mundësojnë krijimin e tyre.

Përfundime

Në mësimdhënien me në qendër nxënësin, nxënësit e mësojnë gjuhën nëpërmjet veprimtarive komunikuese të tilla si: lojërat gjuhësore, puna me role, zgjidhja e detyrave. Veprimtaritë janë tërësisht komunikative. Komunikimi përfshin aftësitë gjuhësore dhe shoqërore të njerëzve. Roli dhe detyrat e mësuesit në një orë mësimi ku ndërveprohet lidhet me të gjithë procesin e mësimi duke filluar që nga shpjegimi, i pyeturi, organizimi i detyrave, qartësia dhe aftësia për të nxitur ndërveprimin e deri tek përvetësimi dhe komunikimi në gjuhën angleze. Nëse realizohen me sukses të gjithë këta komponentë, atëherë lehtësohet mësimnxënia.

Mësuesi si organizues përshtat mësimdhënien me strategjitë, teknikat dhe stilet e të nxënësit. Mësuesi vlerëson, motivon dhe nxit nxënësit për t'u përfshirë në procesin e mësimnxënies. Mësuesi duhet të jetë gjithmonë i gatshëm t'i

ndihmojë nxënësit e vet në çdo kohë. Krijimi i kushteve në klasë dhe veprimtarive ndërvepruese rrit dhe përforcon besimin tek nxënësit. Veprimtaritë me bazë nxitjen e mendimit kritik motivojnë nxënësit për të punuar si individualisht ashtu edhe në grup për detyra të ndryshme si eseja, diskutimi mbi tema interesante, projekte mësimore. Për këtë arsye mund të themi se mësimdhënia me në qendër nxënësin rrit shprehjen e mendimeve dhe kreativitetin.

BIBLIOGRAFI

- Bardhyl Musai, *Koncepti për mësimdhënien me në qendër nxënësin*, Tiranë, 2003, f. 16-22-26
- Bardhyl Musai, Kualida, *Program për kualifikimin në distancë te arsimtarëve* (Anglisht), Aspekte të mësimdhënies, Tiranë, Pegi, 1997, f. 18.
- Diane Larsen, *Techniques and Principles in Language Teaching*. Oxford University press, 2008, f. 130.
- Didaktika e Gjuhëve të Huaja* 1, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2008, f. 22.
- H. D. Brown, *Teaching by principles: An Interactive approach to language pedagogy*, New York, Addison Wesley Longman, 2001.
- J. Willis & D. Willis, *Challenge and change in language teaching*, Oxford, Heinemann ELT, 1996.
- Jack Richards, *The Language Teaching matrix*, Cambridge University press, 1995, f. 118.
- Leonard H. Clark & S. Starr. S. Irving, *Secondary and Middle School Teaching Methods*. Macmillian Publishing Company, New York, 1991, f. 211.
- N. Schmitt, *Vocabulary in Language Teaching*, Cambridge University Press, New York, 2000.
- P. Eggen & D. Kauchak (2004), *Educational psychology: windows on classrooms* (6th ed.). Upper Saddle River, NJ: Pearson-Merrill. Morgan, C., & Morris, G., *Good teaching and learning*. Buckingham, Open University Press, 1999.
- Peter Westwood, *What teachers need to know about teaching methods*. Victoria: ACER Press, Australian Council for Educational Research Ltd, 2008, f. 59.
- Shpresa Delija & Elida Th. Tabaku, *Language Teaching Methodology*, Geer, Tiranë, 2009, f. 83-86.
- Stephen Krashen, *Direct Instruction of Academic Vocabulary: What About Real Reading?* Në "Reading Research Quarterly", 47 (3), 2012, f. 233.
- W. Wilen, J. Hutchison & M. I. Bosse, *Dynamics of effective secondary teaching*, Pearson-Allyn & Bacon, Boston, 2008